

ZAMIRA ÇAVO

Titulli: Prof. Asoc. Dr.

Fusha e ekspertizës kërkimore: Filozofi; Politologji

Prof. Asoc. Dr. Zamira Çavo ka ndjekur studimet universitare gjatë periudhës 1974-1979 dhe është diplomuar në Filozofi në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike. Ka marrë gradën “Doktor i Shkencave” në vitin 1995 dhe titullin “Profesor i Asociuar” në vitin 2014.

Pas studimeve universitare Prof. Asoc. Dr. Zamira Cavo është angazhuar fillimisht në fushën e arsimit si pedagoge e më tej sociologe, gazetare e juriste në institucione të ndryshme. Gjatë periudhës 1997 – 2001 ka mbajtur postin e nën drejtoreshës dhe me pas drejtoreshës së Shërbimit Social Shtetëror. Gjatë periudhës 2002-2006 ka mbajtur postin e Drejtores së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik. Që prej vitit 2006 punon me kohë të plotë në Universitetin Marin Barleti ku ka mbajtur disa detyra si Përgjegjëse e Departamentit të Shkencave Politike, Zv Rektore, Dekane e Sistemit me Kohë të Pjesshme. Aktualisht është Zëvendës Rektore për Çështjet Akademike.

Prof. Asoc. Dr. Zamira Cavo është autore e tre monografive, e teksteve mësimore Filozofia 12 dhe bashkautore në dy të tjera. Ka rreth 650 artikuj në shtypin e ditës, pjesëmarrje të gjatë në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, publikime të ndryshme në revista me bord editorial, projekte kombëtare si konsulente dhe eksperte në fushën e saj të ekspertizës dhe një përvojë të gjatë në mësimdhënie në lëndë si: “Filozofi”, “Histori e Mendimit Politik European”, “Histori e Mendimit Politik Shqiptar”, “Administrim Publik”, “Komunikim” etj.